

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Narkoshteti dhe farsa elektorale/ Berisha: SHBA ka potencialin për të na ndihmuar
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/12/narkoshteti-dhe-farsa-elektorale-berisha-shba-ka-potencia-lin-per-te-na-ndihmuar/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 17:55:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 17:51:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2ffbdf5f46b913e3c8afa5b9f5f5ebc520255bed94b5248efee385f632587e00
TEKSTI	79293cefd80bf1405e92b07b75c44a9bdb4abfef0e2baf96e4866d82d8901364
PAMJA	f0b5d25da1dfae2a7e3b6a00a292ba5d8458c42f6bec33b67f25ebbbe49fe267

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	677399b5c63d4f5bf4336907ace85a68ea03de88284451b26a300ea45bf06bd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1aacec2ad70d563930838261786de700cb30100de9a4a84245ba11291479ed46
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/677399b5c63d4f5bf4336907ace85a68ea03de88284451b26a300ea45bf06bd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Narkoshteti dhe farsa elektorale/ Berisha: SHBA ka potencialin për të na ndihmuar

19:51 : 12/09/2026 në AKTUALITET, POLITIKE



Sali Berisha ka deklaruar se 'narkoshteti' dhe 'farsa elektorale' kanë qenë dy temat kryesore të diskutimeve gjatë vizitës së tij në Shtetet e Bashkuara.

Gjatë prononcimit me gazetarët në Rinas, Berisha u shpreh se SHBA ka një potencial të jashtëzakonshëm për të ndihmuar Shqipërinë, veçanërisht në garantimin e proceseve zgjedhore dhe në luftën kundër trafikut të drogës.

'Dy problemet më madhore të këtij vendi kanë qenë tema kryesore diskutimi: narkoshteti, farsa elektorale, në të cilat SHBA kanë potencialin më të jashtëzakonshëm për të ndihmuar', deklaroi Berisha.

Ai iu referua edhe qëndrimit të Sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, pas zgjedhjeve në Shqipëri, duke pretenduar se Rama nuk mori një urim nga administrata amerikane.

Lexo edhe:

[Kallëzim ndaj Ramës për bllokimin e pagave? Gjyqtari i Apelit të GJKKO: Do shkojmë sërish në GJK nëse...](#)

["Kërkoj të drejtat e mija"/ Rama pritet me protesta në Vlorë, qytetari: Nuk mund të na impononi si doni ju](#)

Ju u kthyet zoti Berisha. Çfarë ndodh me Shqipërinë tani? Sa e impakton kjo vizitë e juaj atje për Shqipërinë?

Sali Berisha: Pyetje shumë e drejtë.

Po a mund të më thoni ju mua, çfarë ka në Shqipëri sot? A ka një pushtet të bërë copë-copë, që shqiptarët po presin me padurim të arkivohet dhe të hidhet në kalendat e historisë?

Sigurisht shqiptarët kanë shpresën, mendjen, zemrën tek PD.

TË GJITHA



Narkoshteti dhe farsa elektorale/ Berisha: SHBA ka potencialin për të na ndihmuar

19:51 : 12/09/2026



Aksident në Orikum, përplasen dy makina

19:34 : 12/09/2026



Kallëzim ndaj Ramës për bllokimin e pagave? Gjyqtari i Apelit të GJKKO: Do shkojmë sërish në GJK nëse...

19:29 : 12/09/2026



Aksident në Selenicë, makina përplasen me barrierat e rrugës, plagoset shoferja

19:06 : 12/09/2026



Gjykatësi amerikan: Plani i Trump për të përgjysmuar fuqinë punëtore të FEMA-s, ka shkelur ligjin

19:00 : 12/09/2026



Përfitoi 9 hektarë për 1 euro me firmën e Ramës/ Kush është biznesmeni kontrovers Shkëlqim Beshiri

18:40 : 12/09/2026



iPhone 18 Pro dhe 18 Pro Max: Siri me AI dhe bateri më e fuqishme

18:29 : 12/09/2026

Dhe në këtë aspekt... po pse thashë unë ripërtëritje?

Po ndoshta është ripërtëritje për ju personalisht?

Sali Berisha: Jo, jo, jo për mua, ripërtëritje në tërësi, ripërtëritje për partinë, për opozitën, për PD-në, nuk e kisha për veten time.

Zoti Berisha, ju gjatë takimeve jeni shprehur se ndodheni në SHBA për të marrë mbështetje për përpjekjen për të rrëzuar qeverinë Rama. A e morët këtë mbështetje?

Sali Berisha: Jo, unë kam thënë, që të jem i sinqertë, absolutisht në çdo takim, dy problemet më madhore të këtij vendi kanë qenë tema kryesore diskutimi: narkoshteti, farsa elektorale, në të cilat SHBA kanë potencialin më të jashtëzakonshëm për të ndihmuar.

Të mos harrojmë një gjë, është qeveria e SHBA, sekretari Rubio, i cili nuk e uroi Edi Ramën për farsën që bëri.

Por dhëndri bashkëpunon me zotin Edi Rama?

Sali Berisha: Jo, mos i ngatërro çështjet e biznesit me parimet themelore të demokracisë. Pra, nuk e uroi.

Dhe kur e pyetën a i çcat mesazh urimi, jo, tha, ne urojmë vetëm ata të cilët bëjnë zgjedhje të lira.

Pra, e mori atë që meritonte.

Dhe potenciali i tyre, pa diskutim për të ndihmuar... meqë jam këtu po u rikujtoj një gjë, ua kam thënë edhe njëherë, nuk e harroj kurrë. Ishte viti 2005 dhe në atë kohë ish-kryetari i Komisionit të Jashtëm të Senatit të SHBA, Joe Biden, më vonë presidenti, e pyet një gazetar për shqiptarët në Shqipëri. Thotë ata janë njerëz të mrekullueshëm, nuk kemi miq të dashur si ata, por ata kanë një problem të madh, aty nuk bëhen zgjedhje të lira.

Se nuk bënin socialistët, socialistët me zgjedhjet nuk pajtohen.

Ç'është e vërteta, ajo që një ndihmë e vërtetë.

Kështu që potenciali i tyre për të ndihmuar në një proces zgjedhor dhe mekanizmat e tyre janë të mëdha.

Së dyti, po kaq shumë është edhe ndihma, mbështetja e tyre në luftën kundër trafikëve.

Edhe njëherë u lutem, lexojeni pak mesazhin e sekretarit Rubio për Ditën e Pavarësisë.

Merrni dhe studioni 165 mesazhet në ditët e pavarësisë. Kund tjetër që të thuhet se partneriteti për luftën kundër karteleve dhe bashkëpunëtorëve që kërcënojnë sigurinë e qytetarëve tanë, nuk e gjeni.

Pra, them se vërtet ne jemi opozitë, por absolutisht kemi qenë avoketër të interesave më të mira të çdo shqiptari.

Ka edhe një interes të lartë, ju shkuat në SHBA, SHBA do të vijë në selinë e PD, kur pas shumë kohësh vjen në Tiranë ambasadori i SHBA?

Sali Berisha: A jam unë amerikan apo shqiptar? Tani unë flas për veten time.

Etiketa: [Edi Rama](#) [Sali Berisha](#) [SHBA](#)

Lajme të lidhura



Kallëzim ndaj Ramës për bllokimin e pagave? Gjyqtari i Apelit të GJKKO: Do shkojmë sërish në GJK nëse...

19:29 : 12/09/2026



"Kërkoj të drejtat e mija"/ Rama pritet me protesta në Vlorë, qytetari: Nuk mund të na impononi si doni ju

17:49 : 12/09/2026



"Nëse ministri do të shkonte pas berihajit...", Rama sulmon sërish Gjykatën Administrative

16:40 : 12/09/2026



Qytetarët kundër Muzeut Hebraik në Vlorë, Rama i sulmon: Një grup delenxhinjsh!

15:20 : 12/09/2026



Protesta në ditën e 105-të, "The Observer": Shqipëria noton në paratë e drogës, Rama shpërfill akuzat

13:31 : 12/09/2026



'PISA 2025': Pasqyra e deformuar e suksesit të qeverisë me arsimin

11:00 : 12/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.